



Tashmë, të gjithë mund të vaksinohen

Përse vakcina kundër KOVID-it 19 është e rëndësishme ?

Vaksina **mbron** kundër KOVID-it 19.

Nëse vaksinohet një numër i madh njerëzish :

- do të ketë më pak njerëz të sëmurë.
- do të ketë më pak të vdekur.

A jam i detyruar të vaksinohem ?

Jo, nuk jeni i detyruar.

Jeni i lirë të vaksinoheni ose jo.

A duhet të paguaj ?

Jo, vakcina është **falas** për të gjithë.

A është e sigurtë dhe e efektshme vakcina ?

Po, vakcina është e sigurtë. Studimet tregojnë se ajo është e efektshme. **Specialistë të barnave e kanë lejuar vaksinën në Zvicër.** Ata i kanë studjuar vaksinat dhe efektet e tyre. Janë bërë studime me mijëra vetë. Dhjetëra milionë njerëz janë vaksinuar tashmë në botë.

A shkakton efekte negative vakcina ?

Mund të ketë efekte negative, **si me çdo vaksinë tjetër.**

Më shpesh, bëhet fjalë për **lodhje, dhembje koke dhe ethe.** Mund të keni dhembje edhe në vendin e gjilpërës. Këto janë reagime normale, që mund të shkaktohen nga vakcina. Ato janë të lehta e nuk zgjasin.

Shumë rrallë, mund të ketë edhe reagime më të rënda. Mund të ketë për shembull ndonjë reagim alergjik. Por kjo ndodh menjëherë pas vaksinimit. Në atë moment, ju ndodheni në prani të punonjësve të shëndetit.

Unë e kam kaluar KOVID-in 19, a duhet të vaksinohem ?

Po, vaksinohuni nëse e keni kaluar **para gjashtë muajsh.** Në këtë rast, një vaksinë e vetme mjafton.

Kush nuk duhet të vaksinohet ?

Ju nuk duhet të vaksinoheni nëse jeni **alergjik ndaj substancave që gjenden në vaksinë.** Para se të vaksinoheni, do t'ju bëhen pyetje për këtë.

Ku mund të vaksinohem ?

Mund të vaksinoheni në një **barnatore** ose te **mjeku juaj**.

Mund të shkoni edhe në një **qendër të madhe vaksinimi**, në spital, ose në «Beaulieu» (Lozanë) për shembull.

Një skuadër do të vijë në rajonin tuaj. Shikoni afishet **në lagjen tuaj** dhe informohuni pranë shoqatave që njihni.

Si të marrim takim ?

Mund të thërrisni këtë numër : **058 715 11 00**
Mund të regjistroheni nga dikush që njeh gjuhën shqipe.

Mund të regjistroheni edhe në këtë **adresë interneti**: www.coronavax.ch

Si bëhet vaksinimi ?

Së pari, do t'ju pyesin nëse keni ndonjë alergji apo nëse jeni shtazanë.

Pastaj, do t'ju bëhet një gjilpërë në pjesën e sipërme të krahut.

Duhet **të prisni 15 minuta** para se të ikni.

Keni nevojë për një gjilpërë të dytë pas një muaji, veç nëse e keni kaluar KOVID-in. Takimin për gjilpërën e dytë e merreni në vend.

E RËNDËSISHME: nëse keni ethe apo ndiheni i sëmurë, mos ejani të vaksinoheni. Bëni një test të KOVID-it 19 më përpara.

A duhet të vazhdoj ta mbaj maskën pas vaksinimit ?

Po. Tani për tani, **të gjithë** duhet të vazhdojnë të zbatojnë rregullat e caktuara.

Pra, është **shumë e rëndësishme** mbajtja e maskës dhe ruajtja e largësisë.

Eshtë mënyra më e mirë për të mbrojtur ata që nuk janë vaksinuar.

A mund të udhëtoj pas vaksinimit?

Po, por duhet të informoheni për rregullat në vendin ku dëshironi të shkoni.

Kam ende pyetje për vaksinën...

Mund të thërrisni këtë numër: **058 715 11 00**

Ju do të gjeni informacione në 9 gjuhë të huaja në www.vd.ch/corona-multilingue.

Po ashtu, mund **skanoni këtë Kod QR**.

